



UNMIK



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETË QEVERISËSE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT  
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION  
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE  
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrat

Office of Minister

Kancelarija Ministra

## UDHËZIM ADMINISTRATIV

### Këshilli Qendror i Shkencës

**NUMËR: MASHT[I] 19/2006**

**DATË: 21.6.2006**

Në bazë të nenit 1.3 pika ( d ) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes në Kosovë, nenit 20, 53, 54, 55, 56, 57 të Ligjit për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më poshtë MASHT) nxjerr këtë Udhëzim Administrativ:

#### Neni 1

##### Qëllimi

Me këtë Udhëzim administrativ (në tekstin e mëtejme Udhëzimi) rregullohen procedurat e themelimit, mandati, organizimi dhe veprimtaria e Këshillit Qendror të Shkencës të Kosovës (në tekstin e mëtejme Këshilli).

#### Neni 2

##### Statusi

Këshilli themelohet si trup i pavarur profesional në shkallë kombëtare me qëllim të përkujdesjes për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në Kosovë.

### **Neni 3** **Detyrat**

Këshilli kryen këto detyra:

1. Këshillon, ndërmerr, ndihmon dhe promovon kërkime shkencore dhe industriale në fusha të ndryshme relevante për Kosovën;
2. Shërben si Këshill mbikëqyrës për të gjitha institutet shkencore në Kosovë si dhe ofron kahet orientuese të zhvillimit të veprimtarisë shkencore në institucione të tjera që merren me veprimtari shkencore;
3. Në bashkëpunim me institucione të tjera, themelon, udhëheq dhe mirëmban Bibliotekën Kombëtare të shkencës (përfshirë regjistrin e veprimtarisë shkencore);
4. Hulumton, zhvillon dhe përcakton standardet dhe metodat e kërkimeve shkencore;
5. Përgatit planin zhvillimor të shkencës kosovare;
6. Harton Programin kombëtar të shkencës dhe propozon miratimin e tij në Kuvend;
7. Në bashkëpunim me institucione përkatëse, punon për standardizimin dhe certifikimin e mjeteve teknike dhe shkencore që përdoren në Kosovë;
8. Administron aktivitetet e veta hulumtuese e zhvillimore, si dhe grante të ndryshme të fituara nga burime të ndryshme me qëllim të avancimi të punës shkencore;
9. Këshillon ministrin për planifikimin, vendosjen e prioriteteve, zotimin dhe ndarjen e mjeteve buxhetore për punë shkencore;
10. Propozon politika për organizimin e veprimtarisë shkencore dhe të punës së institucioneve shkencore;
11. Ofron shërbime teknologjike dhe shkencore për komunitetin shkencor e industrial;
12. Vlerëson gjendjen në veprimtarinë shkencore;
13. Propozon themelimin e institucioneve të reja shkencore;
14. Propozon riorganizimin ose ristrukturimin e institucioneve ekzistuese kërkimore-shkencore të Kosovës;
15. Propozon mbylljen e institucioneve ekzistuese kërkimore-shkencore të Kosovës;
16. Propozon masa për përparimin e veprimtarisë shkencore;
17. Koordinon dhe bashkëpunon në mënyrë të përhershme me institucionet dhe bërthamat për kërkime shkencore në Kosovë;
18. Zhvillon kontakte dhe vendos bashkëpunim të përhershëm me këshillat homologe të vendeve të jashtme;
19. Jep mendime profesionale për çështje shkencore në Kosovë;
20. Propozon buxhetin për realizimin e Programit kombëtar të shkencës.

### **Neni 4** **Struktura e Këshillit**

Në kuadër të Këshillit Qendror të Shkencës funksionojnë edhe Komisioni Ekzekutiv i Këshillit dhe struktura administrative / profesionale.

## **Neni 5**

### **Përbërja e Këshillit**

Këshilli ka 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë dhe përbëhet nga:

- a) kryetari
- b) sekretari dhe
- c) 13 anëtarët prej të cilëve 7 (shtatë) anëtarë të Komisionit Ekzekutiv.

## **Neni 6**

### **Komisioni Ekzekutiv i Këshillit**

1. Këshilli ka Komisionin e vet Ekzekutiv, i cili përbëhet nga 5 anëtarë të zgjedhur nga përbërja e Këshillit;
2. Kryetari dhe Sekretari i Këshillit janë anëtarë të Komisionit Ekzekutiv;
3. Komisioni Ekzekutiv mblidhet së paku një herë në muaj dhe bën menaxhimin në shkallë operative të punëve dhe të veprimtarisë;
4. Komisioni merr vendime me shumicë votash për çështje që nuk kanë të bëjnë me planifikimin strategjik, bërjen e politikave, strukturën dhe veprimtarinë e institucioneve shkencore dhe çështje të tjera të rezervuara për Këshillin;
5. Komisioni përgatit për miratim planet e punës, verisonet punuese të politikave dhe standardeve, projektet zhvillimore dhe punësimin e të tjera;
6. Komisioni i raporton Këshillit në mbledhjet e rregullta (së paku 4 herë në vit) për aktivitetet dhe veprimtarinë gjatë kohës ndërmjet dy mbledhjeve të Këshillit;

## **Neni 7**

### **Shërbimi profesional**

1. Këshilli ka shërbimin e vet administrativ / profesional që ndihmon në kryerjen e punëve profesionale dhe teknike;
2. Përshkrimin e detyrave, përbërjen dhe rekrutimin e shërbimit profesional e bën Komisioni Ekzekutiv i Këshillit;
3. Miratimin e përbërjes së shërbimit profesional e bën Këshilli.

## **Neni 8**

### **Kriteret për zgjedhje / emërim në Këshill**

1. Anëtarët e Këshillit mbulojnë të gjitha fushat shkencore;
2. Anëtarët e Këshillit do të zgjedhen nga radhët e personave më kompetentë në shkencën në Kosovës

## **Neni 9**

### **Zgjedhja**

1. Këshilli themelohet nga radhët e anëtarëve të propozuar
2. Zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit e bën Kuvendi i Kosovës

## **Neni 10**

### **Propozimet**

Procedura e zgjedhjes fillon me propozimet e anëtarëve të mundshëm për Këshillin Qendror të Shkencës .

## **Neni 11**

### **Procedura e propozimeve**

1. Propozimet e para për anëtarë të mundshëm të Këshillit, i bëjnë institucionet shkencore të Kosovës në adresën e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, mbi bazë të propozimeve të institucioneve shkencore, i propozon Qeverisë së Kosovës anëtarët e mundshëm për Këshill.
3. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë mund të propozojë edhe kandidatë që nuk janë përfshirë në listën e propozimeve të institucioneve shkencore të Kosovës.

## **Neni 12**

### **Afati**

Mandati i anëtarit, kryetarit dhe sekretarit të Këshillit zgjat 4 vjet.

## **Neni 13**

### **Konstituimi i Këshillit**

1. Këshillin e përbëjnë anëtarët e zgjedhur të tij dhe konstituohet në tubimin e parë zyrtar
2. Deri në zgjedhjen e kryetarit, Këshillin e udhëheq përfaqësuesi i autorizuar i MASHT-it.

**Neni 14****Lirimi i anëtarit të Këshillit**

Anëtari i Këshillit lirohet nga funksioni në këto raste:

1. Në bazë të kërkesës personale të anëtarit të Këshillit për lirim;
2. Lirimi i anëtarit të Këshillit sipas paragrafit 1 të nenit paraprak bëhet automatikisht pas paraqitjes së kërkesës për lirim;
3. Për lirim të anëtarit të Këshillit lajmërohet Ministria dhe Qeveria me shkrim brenda afatit prej një jave.

**Neni 15****Procedura e shkarkimit të anëtarit të Këshillit**

1. Për udhëheqjen e procedurës së shkarkimit të anëtarit të Këshillit formohet komision i veçantë prej 3 anëtarësh;
2. Komisionin e sipërsënuar e themelon Këshilli nga radhët e anëtarëve;
3. Komisioni përgatit Raport me shkrim për arsyeshmërinë e shkarkimit të anëtarit të diskutueshëm dhe propozon masën e shkarkimit;
4. Propozimi për shkarkim i paraqitet Kuvendit;
5. Vendimin për shkarkimin e anëtarit e merr Kuvendi.

**Neni 16****Arsyet për shkarkim të anëtarit të Këshillit**

Anëtari i Këshillit mund të shkarkohet para skadimit të mandatit në këto raste:

1. Në bazë të kërkesës së kryetarit të Këshillit;
2. Në bazë të kërkesës së më së paku 5 anëtarëve të Këshillit;
3. Si pasojë e mospërbushjes së detyrimeve të anëtarit të Këshillit;
4. Si pasojë e humbjes së aftësisë për ushtrimin e funksionit të anëtarit të Këshillit;
5. Si pasojë e sjelljes që ulë dinjitetin e funksionit të anëtarit të Këshillit.

**Neni 17****Humbja e statusit të anëtarit të Këshillit**

Anëtari i Këshillit humb statusin e anëtarit në këto raste:

1. Në bazë të kërkesës së vet anëtarit;
2. Në bazë të vendimit për shkarkimin e tij;
3. Për shkak të mosvijueshmërisë dhe mospjesmarrjes në aktivitete;
4. Në bazë të pushimit të mandatit.

**Neni 18****Njoftimi i Kuvendit**

Për humbjen e statusit të anëtarit të Këshillit, kryetari i Këshillit e njofton Kuvendin e Kosovës me shkrim, më së voni një javë pas ndryshimit të përbërjes.

## **Neni 19**

### **Kryetari dhe sekretari i Këshillit**

Kryetari dhe sekretari i Këshillit zgjedhen nga radhët e anëtarëve të Këshillit, sipas procedurës vijuese:

1. Për zgjedhjen e kryetarit dhe të sekretarit të Këshillit, Këshilli formon komision të veçantë prej 3 anëtarësh, prej të cilëve njëri është nga MASHT.
2. Komisioni vlerëson kushtet e kandidatëve dhe propozon kandidatët (2) për kryetar dhe sekretar të Këshillit dhe përgatit Raport me shkrim, me arsyetimin për kandidatët e propozuar .
3. Për udhëheqjen e procedurës së votimit Këshilli formon komision zgjedhor, i cili përgatit dhe udhëheq procedurën zgjedhore.
4. Propozimet e komisionit arsyetohen para anëtarëve të Këshillit dhe pastaj votohen prej tyre.
5. Votimi për zgjedhjen e kryetarit dhe të sekretarit të Këshillit bëhet me vota të fshehta.
6. Për votim është e nevojshme prania e 2/3 te numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.
7. Vendimi merret me shumicë absolute të anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote .
8. Komisioni zgjedhor komunikon rezultatin e votimit për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit.

## **Neni 20**

### **Detyrat e kryetarit të Këshillit**

Kryetari i Këshillit ka funksion ekzekutiv dhe kryen këto detyra:

1. Përgatit dhe thërret takimet e Këshillit;
2. Udhëheq punën e Këshillit;
3. Kryen detyra ekzekutive ndërmjet dy mbledhjeve të Këshillit;
4. Menaxhon pjesën administrative dhe profesionale të Këshillit;
5. I raporton Këshillit për punët e kryera në fushëveprimin e vet;
6. Përgatit raporte të rregullta të punës dhe raporte vjetore financiare;
7. Bashkërendit përgatitjen e planeve të punës për miratim nga Këshilli;
8. Bashkërendit punët dhe bashkëpunimin me institutet dhe institucionet kërkimore e shkencore në Kosovë;
9. Përfaqëson Këshillin brenda dhe jashtë Kosovës.

## **Neni 21**

### **Detyrat e sekretarit të Këshillit**

1. Mban procesverbalet dhe përgatit materialet e mbledhjeve;
2. Sistemon dhe ruan dokumentacionin e Këshillit;
3. Përcjell zbatimin e ligjshmërisë në punën e Këshillit
4. Ndhmon kryetarin e Këshillit në përmbarimin e detyrave dhe përgjegjësive të veta;
5. Shërben si drejtues administrativ i Këshillit;
6. I raporton Këshillit dhe kryetarit të Këshillit për punët dhe përgjegjësitë nga fushëveprimi i vet;

## **Neni 22**

### **Procedura për lirimin e kryetarit / sekretarit**

Procedura për lirim nga funksioni i kryetarit të këshillit mund të fillojë në bazë të kërkesës personale të tij për lirim nga ky funksion.

## **Neni 23**

### **Procedura për shkarkimin e kryetarit / sekretarit**

1. Procedura për shkarkimin e kryetarit të këshillit mund të fillojë në bazë të kërkesës të më së paku 5 anëtarëve të Këshillit;
2. Procedura për shkarkimin e sekretarit të këshillit mund të fillojë në bazë të kërkesës të më së paku 5 anëtarëve të Këshillit .

## **Neni 24**

### **Marrja e vendimit për lirim / shkarkim të udhëheqësve të Këshillit**

1. Vendimi për lirim, sipas paragrafit 1 të nenit 22, merret automatikisht pas shqyrtimit të kërkesës së tij për lirim, në rastet kur kërkesa bëhet për çështje personale.
2. Në rastet kur kërkesa bëhet për shkaqe të tjera, marrja e vendimit për lirim nga funksioni bëhet në bazë të rekomandimit të komisionit i cili e shqyrton atë.
3. Për udhëheqjen e procedurës për shkarkimin e udhëheqësve të Këshillit, sipas paragrafit 1 të nenit 23, formohet komision i veçantë prej 3 anëtarësh për vlerësimin e arsyeshmërisë së shkarkimit të tyre.
4. Vendimin për shkarkimin e udhëheqësve e merr Këshilli me 2/3 e votave të anetareve të Këshillit.

## **Neni 25**

### **E drejta e ankesës për shkarkim**

1. Në rastin e shkarkimit të kryetarit ose të sekretarit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në MASHT, në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit të Këshillit.

2. Ankesa i dorëzohet Komisionit për ankesa të Këshillit.
3. Komisioni për ankesa shqyrton ankesën e kryetarit/sekretarit dhe ia dorëzon MASHT-it, e cila merr vendim.

## **Neni 26**

### **Kushtet e punës**

Anëtarët, sekretari dhe kryetari i Këshillit duhet të kenë kushte optimale të punës (hapësirë të mjaftueshme dhe funksionale, inventar dhe pajisje të nevojshme për punë)

## **Neni 27**

### **Statusi i anëtarëve të Këshillit**

Anëtari, sekretari as kryetari i Këshillit nuk krijojnë marrëdhënie të rregullt pune në Këshill, por angazhohen me normë të caktuar të punës.

## **Neni 28**

### **Rregullorja e punës**

Këshilli obligohet që, në afat prej një muaji nga dita e themelimit të tij, të hartojë Rregulloren e vet të punës.

## **Neni 29**

### **Programi i kërkimeve-shkencore**

Këshilli, në afat prej një viti nga themelimi i tij, duhet të përgatisë programin kërkimor-shkencor të Kosovës për 5 vitet e ardhshme.

## **Neni 30**

### **Miratimi i Programit**

1. Programin kërkimor-shkencor Këshilli ia dorëzon MASHT-it / Qeverisë së Kosovës me propozim për miratimin e tij;
2. Qeveria, pas shqyrtimit të Programit, atë ia dorëzon Kuvendit të Kosovës me propozim për aprovimin e tij;
3. Miratimi i Programit të Këshillit bëhet në Kuvendin e Kosovës.

## **Neni 31**

### **Plotësimet / ndryshimet e Programit**

Plotësimet dhe ndryshimet e Programit të shkencës bëhen sipas të njëjtës procedurë.



**Neni 32****Vëllimi dhe ritmi i punës:**

1. Anëtarët e Këshillit marrin detyra në vazhdimësi dhe kryejnë punë individuale në kuadër të fushës përkatëse.
2. Anëtarët e Këshillit, në takimet e punës, raportojnë për punët e kryera dhe marrin detyra vijuese.
3. Këshilli takohet 2 herë në muaj për të trajtuar çështje të ndryshme nga fushëveprimtaria e Këshillit.
4. Këshilli cakton një procesmbajtës për mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit.
5. Këshilli harton kalendarin e vet vjetor të takimeve të rregullta me të cilin përcakton dinamikën e veprimeve të veta.
6. Sipas nevojës, me kalendar, mund të parashihen edhe takime shtesë.

**Neni 33****Raportimi**

1. Anëtarët e Komisionit Ekzekutiv përgatisin raporte me shkrim për punën e vet në Këshill.
2. Këshilli përgatit Raport me shkrim për punën e vet çdo tre muaj dhe ia dorëzon MASHT-it .
3. Çdo vit kalendarik Këshilli përgatit Raport me shkrim për punën e vet dhe ia dorëzon MASHT-it dhe Qeverisë së Kosovës.
4. Çdo vit kalendarik Këshilli përgatit Raport me shkrim për realizimin e programit të shkencës dhe ia dorëzon MASH-it.
5. Çdo vit kalendarik MASHT përgatit Raport me shkrim për zbatimin e Programit të shkencës dhe ia dërgon Qeverisë dhe Kuvendit.
6. Çdo dy vjet, Qeveria përgatit Raport me shkrim për zbatimin e Programit të shkencës dhe ia dorëzon Kuvendit të Kosovës.

**Neni 34.****Financimi i punës së Këshillit**

1. Buxheti i nevojshëm për punën e Këshillit dhe për krijimin e kushteve të punës sigurohet nga buxheti i Kosovës.
2. Vendimi për buxhet merret në Kuvendin e Kosovës, në bazë të propozimit të MASHT-it dhe Qeverisë.

**Neni 35****Financimi i Programit**

1. Financimi i zbatimit të Programit bëhet nga i fondi i veçantë i cili ndahet nga buxheti i Kosovës.
2. Buxheti për zbatimin e programit propozohet nga Qeveria e Kosovës, në bazë

- të propozimit të MASHT-i.
3. Vendimin për sigurimin e buxhetit të nevojshëm për zbatimin e programit të shkencës e merr Kuvendi i Kosovës.

### **Neni 36**

#### **Pagesa**

1. Anëtarët, sekretari dhe kryetari i Këshillit marrin pagesë për punën që ata bëjnë në Këshill;
2. Pagesa e anëtarit, sekretarit dhe e kryetarit të Këshillit do të caktohet me vendimin e Kuvendit të Kosovës, sipas propozimit të MASHT-it;
3. Kryetari i Këshillit merr një pagesë mujore prej 300 eurosh në muaj;
4. Sekretari i Këshillit merr një pagesë mujore prej 280 eurosh;
5. Anëtarët e Komisionit ekzekutiv marrin pagesë mujore prej 250 eurosh;
6. Anëtarëve të Këshillit u paguhet mëditjet për mbledhjet e Këshillit dhe u kompensohen shpenzimet e udhëtimit;
7. Shërbimi profesional kompensohet në bazë të kriterëve dhe normave të shërbimit civil të Kosovës

### **Neni 37**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me dt. 21 .06.2006

---

**Agim Veliu, ministër**